

LIGJ
Nr. 7679, datë 3.3.1993

PËR TATIMIN MBI BIZNESIN E VOGËL

Në mbështetje të neneve 13 dhe 16 të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari private të pavarur me qëllime fitimprurëse në tregti, në artizanat, në shërbime të ndryshme si transport, shëndetësi, avokaturë dhe në shërbime të tjera i nështrohen tatimit mbi të ardhurat që realizojnë.

Neni 2

Tatimi llogaritet me tarifa proporcionale mbi të ardhurat që realizohen nga shitja ose nga kryerja e shërbimeve, si dhe me kuota fikse dhe derdhet në buxhetin e shtetit.

Neni 3

Llojet e veprimtarive që tatohen me tarifa proporcionale mbi të ardhurat dhe masa e tatimit për çdo lloj veprimtarie, janë:

- a) Tregtarët me pakicë që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta, 5 për qind, por jo më pak se 12 mijë lekë në vit.
- b) Artizanët e personat e tjerë fizikë që kryejnë shërbime publike në dyqane ose në njësi të tjera të veçanta, 3 për qind;
- c) Avokatët, mjekët e stomatologët, 8 për qind;
- ç) Specialistët si inxhinierët, mësuesit, veterinerët, financierët, agronomët etj, të kësaj natyre që aktivitetin e tyre e kryejnë në mënyrë të pavarur, 3 për qind;
- d) Personat fizikë privatë që organizojnë kurse të ndryshme për patenta, 10 për qind;
- dh) Personat fizikë që përdorin salla lojrash etj. të ngjashme me to, 10 për qind;
- e) Traktoristët, kombajnerët, zetoristët etj, që kryejnë shërbime bujqësore, transporti etj., 3 për qind;
- ë) Të gjitha mjetet e lundrimit ujor që përdoren për transport pasagjerësh e mallrash, 5 për qind;
- f) Të gjithë personat fizikë që ushtrojnë veprimtari prodhuese të pavarur të tilla si furra gëlqereje, prodhim tulla, prodhim tjegulla etj., të kësaj natyre (përfshirë prodhimet e karakterit të ushqimit social), 3 për qind;
- g) Çdo aktivitet tjetër i pavarur fitimprurës që ushtrohet në dyqane ose në njësitë e tjera të veçanta i përmendur në pikat e mësipërme të këtij neni, 5 për qind;
- gj) Tregtarët që bëjnë tregti me shumicë të çdo lloji, 6 për qind të të ardhurave, por jo më pak se 50 mijë lekë në vit;
- h) Personat që kryejnë riparime e shërbime lokale të veçanta për artikujt elektro-shtëpiakë, 5 për qind, por jo më pak se 12 mijë lekë në vit.

Neni 4

Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë

tatim vjetor me kuotë fikse në këtë masë:

- a) Tregtarët me pakicë të çdo lloji, 12. 000 lekë në vit.
- b) Shërbimet në transportin e udhëtarëve, 5 për qind të të ardhurave por jo më pak se:
 - 15. 000 lekë në vit për automjetet deri në 5 vende;
 - 30. 000 lekë në vit, për automjetet nga 6 deri në 10 vende;
 - 60. 000 lekë në vit, për automjetet nga 11 deri 25 vende;
 - 90. 000 lekë në vit, për automjetet nga 26 deri në 42 vende;
 - 100. 000 lekë në vit, për automjetet mbi 42 vende.

Për shërbimet në transport brenda rrethit, 4 për qind të të ardhurave, por jo më pak se 80 për qind e shumave absolute të përcaktuara sipas nëndarjeve të mësipërme.

Për shërbimet në transportin e mallrave:

- 30. 000 lekë në vit, për automjetet deri në 2 tonë;
- 50. 000 lekë në vit, për automjetet nga 2 tonë deri në 5 tonë;
- 70. 000 lekë në vit, për automjetet nga 5 tonë deri në 10 tonë;
- 85. 000 lekë në vit, për automjetet nga 10 tonë deri në 16 tonë;
- 100. 000 lekë në vit, për automjetet mbi 16 tonë.

c) Për varkat në shërbim të pushuesve, 6. 000 lekë.

ç) Personat fizikë që kryejnë shërbime, si lustraxhi e të tjera të kësaj natyre, 2. 000 lekë në vit.

d) Personat që kryejnë riparime e shërbime të artikujve elektro-shtëpiakë e radio televizorësh, 12. 000 lekë në vit.

dh) Marangoz, murator, elektrikist, bojaxhi, hidraulik, e të tjerë si këta, 9. 000 lekë në vit.

e) Për veprimatri të tjera ambulante që nuk përmenden në pikat e mësipërme të këtij neni, 5. 000 lekë në vit.

f) Tragtarët me pakicë që veprimatrinë e tyre e ushtrojnë në shtëpi, 5 për qind të të ardhuarve, por jo më pak se 12. 000 lekë në vit.

Neni 5

Tatimi vjetor sipas neneve 3 dhe 4 llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të komunave, bashkive e rretheve brenda muajit janar për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikime të bëra nga punonjësit e organeve tatimore.

Neni 6

Tatimi mbi të ardhurat derdhet në 4 këste në afatet 15 mars, 15 qershor, 15 shtator dhe 30 nëntor të çdo viti. Tatimi me kuota fikse derdhet në mënyrë të barabartë për çdo muaj jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës.

Neni 7

Subjektet e parashikuara në nenin 3 të këtij ligji janë të detyruara të regjistrojnë, dokumentojnë e deklarojnë me shkrim të ardhurat që realizojnë. Deklarata vjetore për të ardhurat e realizuara u jepet organeve tatimore brenda datës 15 janar të çdo viti për vitin paraardhës, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 8

Quhen shkelje të këtij ligji:

- a) Fshehja e të dhënave për të ardhurat dhe pasqyrimi jo i saktë i tyre.
- b) Mosmbajtja e dokumenteve për të ardhurat e realizuara.
- c) Mosparaqitja e deklaratës për të ardhurat e realizuara.
- ç) Mosderdhja në afatin e caktuar e tatimit mbi të ardhurat.

Neni 9

Shkeljet e parashikuara në nenin 8 të këtij ligji kur nuk përbëjnë vepër penale quhen kundërvajtje administrative dhe dënohen:

- Shkeljet e parashikuara në shkronjën “a” me gjobë 5. 000 lekë deri në 10. 000 lekë.
- Shkeljet e parashikuara në shkronjën “b” me gjobë 4. 000 lekë deri në 10. 000 lekë.
- Shkeljet e parashikuara në shkronjën “c” me gjobë 3. 000 lekë deri në 8. 000 lekë.
- Shkeljet e parashikuara në shkronjën “ç” me gjobë 4. 000 lekë deri në 10. 000 lekë.
- Në çdo rast tatimi nxirret 100 për qind.

Neni 10

Ligji nr. 7545, datë 6.1.1992 ndryshuar me ligjin nr. 7590 datë 16.7.1992 “Për tatimin mbi të ardhurat e personave fizikë në sektorët privatë të tregtisë, artizanatit e shërbimeve të tjera”, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

Shpallur me dekretin nr. 484, datë 9.3.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.